

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 23.07.2024*

**23.07.2024
Ora 11:08**

RENDI I DITËS

Projektvendim: “Shqyrtimin e kërkesave për regjistrimin e disa partive politike si subjekt zgjedhor për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë, të datës 4 gusht 2024”.

PJESËMARRJA :

KQZ:

- **Z. Ilirjan Celibashi,** Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
- **Stafi KQZ:** Znj. M. Koja, znj. J. Josifi, znj. P. Doçaj.
- Parti Politike:** PD (Z. F. Nuri)
- Të tjerë:** KRIIK

Z. I. Celibashi: Mirëdita të gjithëve! Atëherë, në seancën e sotme publike kemi në rend dite: “Shqyrtimin e kërkesave për regjistrimin e disa partive politike si subjekt zgjedhor për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë, të datës 4 gusht 2024”. Po, atëherë, Pavlina, fjalën për të relatuar në mënyrë të përmbledhur të gjitha kërkesat e paraqitura.

Znj. P. Doçaj: “Partia Socialiste e Shqipërisë”, “Partia Republikane e Shqiptare”, “Partia Demokristiane e Shqipërisë”, “Partia Fryma e Re Demokratike”, “Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut”, “Partia e Lirisë”, “Partia Balli Kombëtar”, “Partia Demokratike”, “Partia Agrare Ambjentaliste e Shqipërisë”, “Partia Balli Kombëtar Demokrat”, “Partia Bashkimi Demokrat Shqiptar”, këto parti politike kanë depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, kërkesën për t’u

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 23.07.2024*

regjistruar si subjekte zgjedhore në zgjedhjet e pjesshme për kryetar të Bashkisë Himarë, që do të zhvillohen me datën 4 gusht 2024. Kërkesat e paraqitura nga partitë politike kanë respektuar afatin kohor të parashikuar me vendimin numër 3 të datës 17.07.2024 të Kolegjit Zgjedhor dhe këto kërkesa kanë qenë të shoqëruara me dokumentacionin e përcaktuar në nenin 64 pika 2 dhe nenin 92/2, pika 2 e Kodit Zgjedhor. Bashkëlidhur keni dhe projektvendimet për shqyrtimin e këtyre kërkesave.


Z. I. Celibashi: Po, faleminderit! Përfaqësuesit e partive politike?

Z. F. Nuri: Po faleminderit zoti Komisioner, ashtu sikundër u relatua nga administrata e KQZ-së edhe “Partia Demokratike e Shqipërisë” ka depozituar brenda afateve ligjore, të gjithë kërkesat dhe të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, përfshirë dhe vërtetimin e Gjykatës për regjistrimin në zgjedhjet vendore në Bashkinë e Himarës, të datës 4 gusht 2024. Nisur nga sa më sipër, ne e përsërisim dhe njëherë: kërkojmë regjistrimin e subjektit “Partia Demokratike e Shqipërisë” për këto zgjedhje. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Po, faleminderit! Atëherë, meqënëse dokumentacioni i paraqitur nga të gjitha partitë aplikuese për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor, “Për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë të datës 4 gusht 2024” është i plotë dhe në përputhje me parashikimet e Kodit Zgjedhor, miratojmë:

- Regjistrimin si subjekt zgjedhor të “Partisë Socialiste të Shqipërisë” me shkronja nistore PS dhe kryetar zotin Edi Rama.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 23.07.2024*

- Të “Partisë Demokristiane” me shkronjat nistore PDK dhe kryetar zotin Nard Ndoka.
 - Të “Partisë Republikane Shqiptare” me shkronja nistore PR dhe kryetar zotin Fatmir Mediu.
 - Të “Partisë Fryma e Re Demokratike” me shkronja nistore FRD dhe kryetar zotin Sali Shehu.
 - “Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut” me shkronja nistore PBDNJ dhe kryetar zotin Vangjel Dule.
 - “Partia e Lirisë” me shkronjat nistore PL dhe kryetar zotin Ilir Metaj.
 - “Partia Balli Kombëtar” me shkronja nistore PBK me kryetar zotin Adriatik Alimadhi.
 - “Partia Demokratike” me shkronja nistore PD dhe me drejtues Komiteti Nismëtar të përfaqësuar nga zoti Sali Berisha.
 - “Partia Agrare Ambientaliste e Shqipërisë”, me shkronja nistore PAA dhe kryetar zotin Agron Duka
 - “Partia Balli Kombëtar Demokrat” me shkronja nistore PBKD, me kryetar zotin Artur Roshi, dhe
 - “Partia Bashkimi Demokrat Shqiptar” me shkronjat nistore PBD dhe kryetar zotin Ylber Valteri.
- Mirë, çështje të tjera në rend dite nuk kemi. Mirë, faleminderit, seanca mbyllet, ditë të mbarë!

Vendimi nr. 110 - 120

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

